



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.shk.II.nr.1459/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Dytë, në përbërje nga gjyqtari individual Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësllësit “Prishtina” sh.a me seli ne Prishtinë, kundër debitorit “M.G. Suprt Mar. Binjaket” me seli ne Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.84/23, të datës 28.07.2023, me datë 05.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Rajonale e Ujësllësit “Prishtina” sh.a me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.84/23, të datës 28.07.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.84/23, të datës 28.07.2023, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit “M.G. Suprt Mar. Binjaket” me seli ne Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit të Përmbartuesit Privat Irfan Kërçagu P.nr.16/21 të dt.27.01.2021, andaj ka shfuqizuar urdhrin e përmbartimor.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovojë si të bazuar ankesën e kreditorit, ashtu që të ndryshojë aktvendimin e atakuar dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimorë P.nr.16/21 të dt.27.01.2021, ndërkaq prapësimin e debitorit ta refuzoi në tërësi, apo t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala debitore.

Gjykata Komerciale, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Rajonale e Ujësllësit “Prishtina” sh.a me seli ne Prishtinë, me datë 27.01.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorit “M.G. Suprt Mar. Binjaket” me seli ne Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga libri i kontabilitetit per

periudhën 01.01.2013 deri me 26.01.2021, për prestimin e pakryer, ne shumë prej 1,162.61 euro, si dhe te gjitha shpenzimet e procedurës permbarimore.

Përmbartuesi privat Irfan Kërçagu, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.16/21 të dt.27.01.2021, ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datë 08.02.2021, ka ushtruar prapësim duke theksuar se nuk ka date specifike për cilën periudhe është borxhi, nuk janë te përshkruara cilat janë faturat për te cilat kërkohet përmbushja e kredisë, a janë ato fatura te nënshkruara, e as periudha kohore për përmbushjen e detyrimit, me tej debitori ne kundërshtimet e tij ka theksuar se ekstraktit nga libri i kontabilitetit ne rastin konkret nuk përbenë dokument përmbartues, andaj i propozon gjykatës qe te aprovoj kundërshtimet si në prapësim.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori, me dt.10.02.2021, duke theksuar se janë të pa bazuara pretendimet e debitorit në prapësim dhe se e kundërshton kërkesën e debitorit që të mos realizohet përmbartimi duke theksuar se debitori nuk e ka dhënë asnjë arsye si ne kuptim te nenit 71 te LPP qe te aprovohet prapësimi, andaj edhe ka kërkuar që të refuzoi prapësimin, dhe urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.84/23, të datës 28.07.2023, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.16/21 të dt.27.01.2021, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivit të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka gjetur se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim të dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga libri i kontabilitetit per periudhën 01.01.2013 deri me 26.01.2021, për prestimin e pakryer, ne shumë prej 1,162.61 euro, mbi bazë të së cilës përmbartuesi privat e ka lejuar përmbartimin, por ky dokument nuk përben bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ngase nuk i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 dhe 37 të LPP-së, për faktin se ky dokument nuk e ka cilësinë e dokumentit përmbartimor, e po ashtu nga shiqimi ne këtë dokument rezulton se nuk ka date specifike për cilën periudhe është borxhi, nuk janë te përshkruara cilat janë faturat për te cilat kërkohet përmbushja e kredisë, a janë ato fatura te nënshkruara, e as periudha kohore për përmbushjen e detyrimit. Andaj edhe mbi bazën e këtyre fakteve gjykata e shkallës së parë ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, në bazë të dokumentit të besueshëm- ekstraktit nga libri i kontabilitetit per periudhën 01.01.2013 deri me 04.02.2021, ku me dispozitivin e nenit 29 të Ligjit për Procedurën

Përbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është, është i përshtatshëm për përbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentin- e cila nuk paraqet dokument të besueshëm, pasi që ne te nuk janë paraqitur te dhënat e nevojshme për identifikimin e debitorit dhe rrjedhimisht propozimi për përbarim përmban te meta ne kuptim te nenit 38, par.1 te LPP te cilat nuk mund te evitohen ne këtë faze te procedurës. E po ashtu edhe gjykata e shkallës së dyte, pajtohet ne tërësi me qëndrimin juridik te gjykatës se shkallës së parë ky dokument nuk përbën bazë juridike për caktimin e përbarimit, ngase nuk i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 dhe 37 të LPP-së, për faktin se ky dokument nuk e ka cilësinë e dokumentit përbarimor, pasi qe nga shikimi ne ekstrakt rezulton se shuma e kërkuar është për periudhë kohore 01.01.2013 e deri me 26.01.2021, mirëpo në ekstrakt nuk është pasqyruar saktë rrjedha e borxhit në rubrikën “Saldo”, figuron borxhi para datës 31.12.2013, në lartës prej 1,629.69 euro, ndërsa në ekstrakt nuk është treguar periudha kohore për të cilën është krijuar ky borxh fillestar dhe rrjedhimisht nuk mund të vërtetohet se si ka ardhur deri të borxhi kryesor i cili tani kërkohet nga kreditori për përmbushje. Prandaj ekstrakti mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe rrjedhimisht nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm, ashtu që rezultojnë si të pa themelta pretendimet ankimore në këtë drejtim

Kjo gjykatë vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga raporti detyrimor në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të pa përshtatshme për përbarim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Gjykata e shkallës së dytë i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të kreditorit, por të njëjtat nuk ndikuan në një vendim ndryshe.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.1459/2023, me datë 05.03.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami, d.v.